

Letër këshilluese 2007-1

Maj 2007

Parandalimi i Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit

1. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj letre këshilluese është të siguroj udhëzimet për një ndihmë shtesë për bankat dhe institucionet financiare në implementimin e aspekteve të caktuara kundër shpërlarjes së parave dhe për luftimin e financimit të terrorizmit (KSHP/LFT), sipas kërkesave të Rregullores së ndryshuar 2004/2 mbi pengimin e shpërlarjes së parave dhe veprave të ngjashme penale dhe Rregullës X, të ndryshuar, mbi parandalimin e shpërlarjes së parave dhe të financimit të terrorizmit, të autorizuar sipas neneve 20.1(a), 22, 24, 28.1(f), 32, 33 dhe 46 të Rregullores nr. 1999/21 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave.

2. PËRMBLEDHJA E UDHËZIMEVE TË KSHP/LFT

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK) e pranon që territori i Kosovës mund të bëhet shënjestër e shpërlarjes së parave. Prandaj, është e nevojshme mbrojtja e integritetit financiar dhe operacional të tregjeve vendore dhe ndërkombëtare. Si rrjedhojë, theks i veçantë i është dhënë kërkesave për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe aktiviteteve për financimin e terrorizmit.

SHËNIME UDHËZUESE

Neni 22 i Rregullores 1999/21 dhe Rregulla X e ndryshuar parasheh që bankat dhe institucionet financiare duhet të informojnë Qendrën Intelgjente Financiare (QIF) për çfardo indikacioni të shpërlarjes së parave dhe të raportojnë transaksionet me shumën të mëdha.

Këto udhëzime të lëshuara nga AQBK janë në pajtim me dispozitat e Rregullores dhe janë të aplikueshme për të gjitha bankat dhe institucionet financiare të licencuara nga AQBK apo të regjistruara në të.

Qëllimi i këtyre udhëzimeve është krijimi i praktikave më të mira në pajtim me standardet ndërkombëtare sipas rregullave dhe rregulloreve të themeluara, dhe krijimi i procedurave standarde të komunikimit në mes të këtyre institucioneve, AQBK-së dhe autoriteteve për hetimin e krimit.

Këto udhëzime na japim një përmbledhje të nenit të Rregullores mbi Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe të Rregullës X të ndryshuar mbi Shpërlarjen e Parave.

Sidoqoftë, duhet theksuar se këto janë udhëzime plotësuese të Rregullores. Këto nuk duhen të interpretohen si zvendësim i Rregullores. Përgjegjësia për vështrimin e ligjeve dhe rregulloreve i takon institucioneve individuale dhe punonjësve të tyre.

DEFINICIONET

Shpërlarja e parave është proces nëpërmes të cilit kriminelët tentojnë të fshehin origjinën e vërtetë dhe pronësinë e të ardhurave nga aktivitetet e tyre kriminale me qëllimin e vetëm për të siguruar një mbulesë legjitime dhe legale të burimeve dhe përfitimeve të tyre financiare. Është një mjet nëpërmes të cilit, organizatat e krimit serioz jetojnë ndershëmrisht pa ndonjë lidhje të dukshme me botën kriminale.

Aktivitetet kriminale. Definicioni i vërtetë i shpërlarjes së parave përcakton aktivitetin fundamental kriminal i cili gjeneron para të cilat duhet pastruar. Vendet e ndryshme kanë adoptuar metoda të ndryshme për adresimin e aktiviteteve fundamentale kriminale. Përderisa disa vende kanë përgjithësuar dhe përfshirë të gjitha aktivitetet kriminale, të tjerat kanë përfshirë një listë të krimeve serioze që janë të prirura për gjenerimin e shumave të mëdha të parave.

PARANDALIMI I SHPËRLARJES SË PARAVE

Interesimi ndërkombëtar për luftimin e shpërlarjes së parave në aspektin global ka kuptuar nevojën që kolektivisht të parandaloj kriminelët, me të gjitha mjetet e mundshme, që të mos lejoj legalizimin fitimeve nga aktivitetet të tyre kriminale duke konvertuar fondet prej të *papastërtave* në të *pastru*.

Edhe pse ekzistojnë metoda të ndryshme të shpërlarjes së parave duke filluar nga blerja e ndonjë prone apo sendeve luksoze deri te rrjetet komplekse ndërkombëtare të një biznesi në dukje legjitim, pastrimi i fitimeve nga aktivitetet kriminale nëpërmes të sistemit financiar është shpesh nevojë vitale për suksesin e operacioneve të tilla kriminale.

Rritja e integritetit të sistemeve ndërkombëtare financiare, e shoqëruar me lëvizjen e lirë të kapitalit nëpërmes të heqjes së barrierave, kanë lehtësuar edhe më shumë pastrimin e parave kriminale duke e lëvizur atë nga një jurisdikcion në një tjetër dhe duke e komplikuar kështu gjurmimin dhe procesin e auditimit.

FAZAT E SHPËRLARJES SË PARAVE

Pavarësisht nga metoda që përdoret për pastrimin e parave, normalisht ky proces kryhet në tri faza. Këto mund të shfaqen si faza të ndara dhe të ndryshme edhe pse mund të ndodhin edhe në të njëjtën kohë duke mbuluar njëra tjetrën, varësisht nga organizatat kriminale që involvohen. Që të trija fazat zakonisht përfshijnë transaksione të shumta nga ana e pastruesve të parave që përpiqen për të fshehur apo maskuar procesin gjurmues. Transaksionet e tilla, sidoqoftë, mund të alarmojnë bankën apo institucionin financiar për aktivitetin e dyshuar kriminal gjatë të këtyre tri fazave:

- Plasmanet – zhvendosja fizike e parave të gatshme të derivuara nga aktiviteti ilegal, p.sh vendosja e tyre në llogari bankare;
- Depozitimi (shtresimi) – krijimi i depozitave të shumta dhe komplekse të transaksioneve financiare si ndarje e fitimeve nga burimi i tyre me qëllim të kamuflimit nga auditimi gjurmues dhe sigurimit të anonimitetit, p.sh transferimet nga njëra llogari në tjetrën, këmbimi i parave, ndërrimi i juridiksionit; dhe
- Integrimi – sigurimi i një spjegimi, në dukje legjitim, për kthimin e pasurisë së derivuar ilegalisht në sektorin ekonomik, p.sh likuidimi i një investimi në mënyrë që fitimi të përdoret për një biznes që në dukje është legjitim.

Procesi i suksesshëm depozitues i thjeshtëson skemat e procesit të integritimit për futjen e sërishme në ekonomi të fitimeve të pastruara, në atë mënyrë që ato do të rihyjnë në sistemin financiar si fonde normale të biznesit.

PËRDORIMI I BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE FINANCIARE

Janë identifikuar disa dobësi në shpërlarjen e parave, të cilave një pastrues parash e ka vështirë t'u shmanget, ku ekziston mundësi më e madhe e identifikimit të aktiviteteve të dyshimta:

- Futja e parave në sistemin financiar;
- Qarkullimi i fondeve nëpër kalimet kufitare; dhe
- Transferet në dhe jashtë sistemit financiar.

Për këtë arsye shumica e vendeve, në një shtrirje të gjerë, kanë koncentruar përpjekjet e tyre në fazën e vendosjes. Parandalimi i përdorimit të sistemit financiar për aktivitete të shpërlarjes së parave, është dëshmuar si më efikas në vështirësimin e procesit të shpërlarjes së parave. Sidoqoftë, kjo nuk mund të parandalojë pastruesin e parave në kërkimin dhe përdorimin e metodave tjera për pastrimin e fitimeve të tij ilegale.

Edhe pse shumica e rregulloreve për parandalimin e shpërlarjes së parave fokusohet në fazën e vendosjes, është theksuar se bankat dhe institucionet financiare, si ofrues të shërbimeve të shumta ende janë të rrezikuara nga shfrytëzimi i tyre në fazat e depozitimit dhe integritimit. Dhënja e kredive dhe transferimi i shpejtë i fondeve nëpër llogari me emra të ndryshëm dhe në juridiksione të ndryshme mund të përdoret si pjesë e procesit për krijimin e depozitave komplekse nga transaksionet.

Bankat dhe institucionet financiare të cilat implikohen në skemat e shpërlarjes së parave do t'i nënshtrohen rrezikut nga persekutimi i mundshëm, humbjes së tregut të mirë dhe humbjes së mundshme të licencës për operim.

3. UDHËZIMET PËR BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE PËR PARANDALIMIN E SHPËRLARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Kujdesi i duhur për klient

Nenet e mëposhtme japin sqarime dhe udhëzim të mëtutjeshëm sa i përket terminologjisë të përdorur në Rregullën e ndryshar X. .

Në aplikimin e një kujdesi të më të madh, bankat dhe institucionet financiare duhet të kujdesen që të mos implikohen në diskriminim në baza racore, ngjyre, religjioni apo kombi.

KLIJENTËT

Klienti nënkupton personin apo entitetin i cili kryen transaksion apo shfrytëzon shërbimet e një banke apo institucioni financiar si dhe çdo pronar, përfitues, person a entitet tjetër në emër të të cilit kryhet transaksioni apo pranohen shërbimet.

MARRËDHËNIA E BIZNESIT

Marrëdhënia e biznesit me bankën apo institucionin financiar do të thotë përdorimi i shërbimeve financiare të bankës apo institucionit financiar për më shumë se një transaksion apo transaksione të rastit. Shërbimet financiare nënkuptojnë ato aktivitete të paraqitura në nenin 1.12 të

Rregullores 2004/2, të ndryshuar. Marrëdhënia e biznesit me bankën apo institucionin financiar nuk nënkupton marrëdhënien e biznesit me bankën apo institucionin financiar në një cilësi tjetër apo përfitim të shërbimeve tjera nga banka apo institucioni financiar.

BIZNESET JO BALLË PËR BALLË

Bizneset jo ballë për ballë mund të përfshijnë:

- a. marrëdhënien e biznesit e cila kryhet nëpërmes të internetit apo në mënyra tjera si nëpërmes të postës;
- b. shërbimet dhe transaksionet nëpërmes të internetit duke përfshirë këmbimin e letrave me vlerë nga investitorët e vegjël, nëpërmes të internetit apo nëpërmes shërbimeve tjera interaktive të kompjuterit;
- c. përdorimi i makinave ATM;
- d. pagesës me telefon;
- e. dërgimi i instruksioneve apo i aplikacioneve me anë të faksimilit apo mënyrave të ngjashme; dhe
- f. kryerja e pagesave dhe pranimi i tërheqjeve të parave të gatshme si pjesë e pikës elektronike të shitjes së transaksioneve duke përdorur letrat me vlerë të parapaguara, të ringarkuara apo të ndërlidhura me llogari.

UDHËZIME SHITESË NË IDENTIFIKIMIN E DOKUMENTEVE

Për verifikimin e identitetit të klientëve të cilët janë persona të zakonshëm, banka apo institucioni financiar duhet të shfrytëzoj dokumente burimore të pavarura dhe të besueshme, të dhëna apo informata siç janë letërnjoftimi apo pasaporta e lëshuar nga qeveria. Identifikimi i njerëzve të zakonshëm dhe verifikimi i identitetit të tyre duhet të përfshij, emrin e plotë dhe adresën, datën (dhe vendin) e lindjes.

Në procesin e sigurimit dhe verifikimit të informatave identifikuese të subjektit (siç është emri i korporatës, adresa e zyrës kryesore, identiteti i drejtorëve, vërtetimi i korporatës apo evidenca mbi statusin ligjor, forma ligjore dhe dispozitat me të cilat autoriteti obligon subjektin) bankat dhe institucionet financiare duhet të shfrytëzojnë dokumentet të cilat vërtetojnë:

- a. emrin e klientit dhe formën ligjore, përfshirë vërtetimin e inkuorporimit apo vërtetimit të ngjashëm të themelimit apo ekzistencës (siç është certifikata e inkuorporimit apo instrumenti i besimit);
- b. emrat dhe adresat e anëtarëve të organit për kontrollin e klientit siç janë drejtorët për kompaninë, kujdestarët për trustet, si dhe për partneritetet e kufizuara, partnerët e përgjithshëm, si dhe menaxhmentin e lartë siç është zyrtari i lartë ekzekutiv;
- c. dispozitat ligjore që kanë autoritet për të obliguar klientin (siç janë memorandumit dhe nenet e asociacionit apo instrumenti i trustit);
- d. dispozitat ligjore që autorizojnë personat të veprojnë në emër të klientit (siç është rezoluta e bordit të drejtorëve apo deklarata e kujdestarëve mbi hapjen e një llogarie dhe autorizimin e atyre që do të operojnë me atë llogari); dhe
- e. identitetin e personit fizik që do të veprojë në emër të klientit.

KUJDESI I SHITUAR PËR KLIENTËT E RREZIKUT MË TË LARTË

Faktorët relevant për të përcaktuar nëse një klient paraqet rrezik më të lartë janë nëse personi:

- a. nuk është banor, apo kombësia dhe vendbanimi aktual apo i mëparshëm i personit indikon për një rrezik më të lartë të shpërblarjes të parave apo financimit të terrorizmit;
- b. është i lidhur me juridiksionet të cilave ju mungojnë standardet e duhura për parandalimin e shpërblarjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
- c. person i ekspozuar politikisht (PEP) apo i lidhur me ndonjë PEP;

- d. individ i lartë i rrjetit;
- e. klient privat banker;
- f. i involvuar në ndonjë biznes që është i dyshimtë për shpërlarjen e parave apo financim të terrorizmit;
- g. person ligjor apo organizatë që është ndërmjetës i mbajtjeve të mjeteve vetanake;
- h. person ligjor apo organizatë me një strukturë pronësie komplekse pa ndonjë arsye të dukshme;
- i. një kompani me akcionarë apo aksione të nominuara në formë të posedimit.

Kjo listë është e pashterrshme kështu që mund të mirren parasysh edhe faktorë tjerë relevant.

Për një vëmendje më të madhe të burimit të pasurisë dhe fondeve të klientit, kujdesi i shtuar ndaj klientit duhet, në mes tjerash, të nënkuptoj edhe:

- a. hetimin e identifikimit të klientit (duke përfshirë edhe poseduesin e benificionit dhe kontrolluesin);
- b. hetimin e legjitimitetit të pranuesit të fondeve;
- c. monitorimin e transaksionit; dhe
- d. profilin e klientit.

Person i ekspozuar politikisht është çdo person të cilit i është besuar ndonjë funksion i rëndësishëm publik në ndonjë shtet¹, si dhe anëtarët e familjes të atij personi apo ata që janë në lidhje të ngushtë me atë person.

Procedurat për përcaktimin se kush është PEP mund të përfshijnë:

- a. kërkimi i informative përkatëse nga klienti potencial;
- b. referimi në informatat publike; dhe
- c. mundësia e çasjes në bazën elektronike të të dhënave të PEP.

Identifikimi i veprave dhe transaksioneve të dyshimta

Disa lloje të caktuara të transaksioneve do të duhej të alarmonin institucionin financiar mbi mundësinë që klienti është duke kryer aktivitete të dyshimta. Këtu mund të përfshihen transaksionet që nuk kanë kuptim ekonomik, ligjor apo komercial, apo që kanë të bëjnë me lëvizje të shumave të mëdha të parave të gatshme, që nuk përkojnë me transaksionet normale dhe të zakonshme të klientit. Një shumë shumë e lartë parash, që nuk përkon me shumën e fondeve që zakonisht mbahen në atë llogari, mund të jetë indikator i shpërlarjes të fondeve. Shembujt e aktiviteteve të dyshimta specifike-bankare mund të jenë shumë të dobishme për institucionin financiar dhe duhet të përfshihen në aktivitetet trajnuese.

Si vepër apo transaksion i dyshimtë, shpesh, mund të merret ai i cili nuk përputhet me njohuritë mbi biznesin legjitim apo aktivitetet personale të klientit, apo me biznesin normal për atë lloj të produktit financiar. Institucioni financiar duhet të grumbulloj informata për të mësuar rreth klientit dhe biznesit të klientit në mënyrë që të kuptojnë më lehtë nëse një transaksion është i pazakonshëm.

Pyetjet të cilat një institucion financiar duhet t'i merr parasysh për të përcaktuar nëse një vepër apo transaksion mund të jetë i dyshimtë janë:

- A është shuma e transaksionit në përputhje me aktivitetet normale të klientit?

[¹ Në pajtim me Rekomandimin 6 të FATF (Financial Action Task Force) AQBK mund të zgjedh nëse kjo do të jetë kusht për PEP-at e huaj apo ta aplikoj edhe për PEP-at vendor.]

- A është transaksioni racional në kontekst të biznesit të klientit apo aktiviteteve personale?
- A ka ndryshuar modeli i transaksioneve të kryera nga klienti?
- Në rast se transaksioni është i një natyre ndërkombëtare, a ka klienti ndonjë arsye të qartë për të kryer biznesin duke përfshirë një vend tjetër?

Disa indikatorë të veprave dhe transaksioneve të dyshimta janë paraqitur në Shtojcë.

Funksionimi i zbatueshmërisë së KSHP/LFT në informimin e transaksionit potencial të dyshimtë

Funksionimi i KSHP/LFT zbatueshmërisë nënkupton pranimin e dëftesës së raportit nga anëtari i personelit dhe në të njëjtën kohë të sjell ndërmend obligimin se nuk duhet të bëj asgjë që mund të dëmtoj hetimet, p.sh 'të paralajmëroj' në kuptimin e nenit 3.12 të Rregullores 2004/2.

Pas pranimit të raportit fillestar, funksioni i brendshëm i zbatueshmërisë së KSHP/LFT duhet të bëjë hetimet përkatëse, ndër të tjera (nëse është e zbatueshme) për:

- a. Origjinën e mjeteve të depozituara;
- b. Arsyen e tërheqjeve të mëdha të mjeteve;
- c. Shpjegimin për depozita të mëdha;
- d. Punën apo aktivitetet e biznesit të klientit si dhe poseduesi e përfitimeve;
- e. Nëse klienti apo poseduesi i përfitimeve është person i ekspozuar politikisht;
- f. Në rastet e entiteteve legale: kush i kontrollon ato entitete.

Varësisht nga rrethanat, në mes tjerash analizat duhet të përfshijnë:

- a. Sigurimin e informatave me shkrim apo me gojë nga klienti apo pronari i përfitimeve,
- b. Vizitat e vendeve të biznesit të klientit apo poseduesit të përfitimeve,
- c. Konsultimin e burimeve dhe bazave të të dhënave me çasje publike,
- d. Informatat nga individët tjerë të besueshëm, nëse paraqitet nevoja.

Udhëzime shtesë rreth informatave mbi zanafillën e transfereve elektronike apo telegrafike

Transferet elektronike apo telegrafike nënkuptojnë çdo transaksion që kryhet në emër të personit zanafillës (qoftë ai i zakonshëm apo ligjor) nëpërmes të institucionit financiar me mjete elektronike, me qëllim që t'i mundësohet personit përfitues në një institucion tjetër çasja në shumën e parave.

Zanafillësi është mbajtës i llogarisë, apo në rastet kur nuk ekziston llogaria, personi (i zakonshëm apo ligjor) i cili i jep urdhër institucionit financiar të kryej transferin elektronik apo telegrafik.

Politikat dhe procedurat mbi informatat e zanafillësit nuk kanë për qëllim të përfshijnë a) çfardo transferi që rrjedh nga transaksioni që kryhet duke shfrytëzuar debit apo kredit kartelën përderisa numri i kredit apo debit kartelës i shoqëron të gjitha transferet që rrjedhin nga transaksioni; b) transferet dhe pagesat në mes të bankave dhe institucioneve financiare ku zanafillëse dhe përfituese janë bankat apo institucionet financiare që veprojnë në emër të tyre.

Kur kredit apo debit kartelat shfrytëzohen si sistem i pagesës për kryerjen e transferit, ato përfshihen në Rregullën e X dhe Udhëzimet e saj, dhe informatat e duhura duhet të përfshihen në mesazh.

Institucionet financiare përfituese, duhet të kenë procedurat e gatshme për identifikimin dhe hetimin e transfereve telegrafike, që nuk posedojnë informatat e plota mbi zanafillën. Procedura për adresimin e këtyre rasteve duhet të përfshijë kërkesën e bankës drejtuar institucionit financiar që ka dërguar transferin telegrafik që të dërgoj informatat që mungojnë për zanafillësin.

Nëse informata që mungon nuk është e disponueshme, atëherë institucioni financiar që ka bërë kërkesën duhet të marr parasysh nëse, në këto rrethana, mungesa e informatave mbi zanafillësin shkakton apo kontribuon dyshimet në lidhje me transferin. Nëse transferi konsiderohet si i dyshimtë, duhet që banka përfituese apo institucioni financiar ta informojnë QIF-in. Pastaj, banka ose institucioni financiar mund të vendos që të mos e pranoj transferin.

Në rrethana të caktuara, kur dy apo më shumë transaksione me mungesë informatash apo me informata jokomplete të zanafillësit, banka përfituese apo institucioni financiar duhet të marr parasysh kufizimin apo ndërprerjen e marrëdhënieve me bankën apo institucionin financiar që nuk zbaton këtë kërkesë.

Udhëzime shtesë mbi raportet korrespondente bankare në kalimet kufitare dhe raportet tjera të ngjashme

Korrespondimet bankare definohe si dispozitë e njërës bankë (korrespondente) ndaj bankës tjetër (përgjegjëse) për kredi, depozita, grumbullim, shërbime shlyerjeje apo pagesash.

Për të vlerësuar kontrollin e bankës përgjegjëse potenciale kundër shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, banka duhet të grumbulloj informata të mjaftueshme për bankën potenciale përgjegjëse, në mënyrë që të kuptoj punën e saj dhe me anë të informatave publike të përcaktoj reputacionin e institucionit, cilësinë e mbikëqyrjes, dhe nëse i është nënshtruar hetimeve apo masave rregulatore për shkak të shpërlarjes të parave dhe financimit të terrorizmit. Banka, në përgjithësi, duhet të vendos që të vazhdoj marrëdhëniet bankare korrespondente me bankën e huaj përgjegjëse vetëm nëse është e kënaqur me mbikëqyrjen e bankës përgjegjëse nga ana e autoritetit. Në veçanti, banka nuk duhet të krijoj apo të vazhdoj raportet bankare korrespondente me bankën përgjegjëse jovendore të inkorporuar në juridiksionin në të cilin banka nuk është prezente dhe e cila nuk është anëtare e grupit të rregulluar financiar (p.sh bankës së panjohur).

Informatat që duhen grumbulluar mund të përfshijnë detaje rreth menaxhmentit të bankës përgjegjëse jovendore, aktiviteteve të mëdha të biznesit, vendndodhjes, përpjekjeve të saj për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, sistemit të rregullimit të bankës dhe mbikëqyrjes në vendin e bankës përgjegjëse, si dhe qëllimin e llogarisë.

Banka duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë marrëdhënieve bankare korrespondente me bankat jovendore të inkorporuara në juridiksionet të cilat nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Në rastet e tilla kërkohet një kujdes i shtuar, duke përfshirë sigurimin e detajeve të pronësisë të bankave të tilla përfituese, si dhe informata më të gjera për politikën dhe procedurat për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Kujdes i veçantë duhet të aplikohet në rastet kur përgjegjësi i bankës lejon përdorimin e drejtpërdrejt të llogarisë së korrespondentit nga palët e treta që kryejnë punën në emër të tyre (p.sh, të pagueshme—nëpërmes llogarive). Banka duhet të jetë e kënaqur që banka përgjegjëse ka pasur kujdes të shtuar ndaj atyre klientëve që kanë çasje direkte në llogaritë e korrespondentit, dhe që përgjegjësi është në gjendje të siguroj informata identifikuese për klientë të caktuar me kërkesën e korrespondentit.

Bankat duhet të dokumentojnë përgjegjësitë e secilit institucion për KSHP/LFT përkatës. Nuk është çdoherë e nevojshme që të dyja bankat të reduktojnë përgjegjësitë përkatëse në formë të shkruar, ngase ekziston mirëkuptimi i qartë sipas të cilit do të zbatohen masat e kërkuara.

Udhëzime shtesë për Zyrat e Këmbimit të Valutave të Huaja dhe Operatorët për Transferin e parave

KUJDESI I SHTUAR PËR KLIENTIN (KSHK) DHE MONITORIMI

Edhe pse kërkesat për identifikim dhe verifikim duhet të zbatohen sipas nenit 3.1(d) të Rregullores 2004/2, aplikimi i kujdesit të shtuar për klientin nuk është i nevojshëm në rastet kur transaksionet me atë klient janë të herë pas herëshme (p.sh disa herë në vit). Në rastet kur transaksionet janë më të shpeshta, marrëdhënia e biznesit duhet të përceptohet si diçka e vazhdueshme, që kërkon procedura të mëtutjeshme për identifikimin e klientit.

MBAJTJA E TË DHËNAVE DHE RUAJTJA

Poashtu në mungesë të një marrëdhënie të vazhdueshme biznesi, Zyrat për Këmbimin e Valutave të Huaja dhe Operatori për Transferin e Parave duhet të ruajnë kopjet e të dhënave identifikuese si dhe të dhënat mbi transaksionet deri në pesë vite pas datës së transaksionit.

[INFORMATAT PËR ZANAFILLËSIN

Operatorët për Transferin e Parave që bëjnë transfere elektronike apo telegrafike nën [$\leq 1,000\text{€}$] nuk kanë nevojë që transferit t'ia bashkangjesin informatat e plota rreth zanafillësit. Por, sidoqoftë, ata duhet që sipas nenit IV(g) të Rregullës XVI, të jenë në gjendje që informatat e plota për zanafillësin t'ia mundësojnë AQBK-së apo QIF-it brenda tri ditë pune pas marrjes së kërkesës.]

RAPORTIMI I TRANSAKCIONEVE

Zyrat për Këmbimin e Valutave të Huaja si dhe Operatori për Transferin e Parave duhet të kenë parasysh faktin se nëse klienti preferon të kryej transaksion të parave nën shumën 10,000 €, me gjasë për t'iu shmangur raportimit, kjo ngjall dyshimin për transaksionin e tillë. Ata poashtu duhet të kenë parasysh se transaksionet e shumëfishta që kryhen nga apo në emër të një personi apo entiteti, për një periudhë kohore, ku totali i atyre transaksioneve e kalon shumën 10,000 € ngjall dyshim për transaksionet e tilla.

Shtojcë për udhëzimet

Indikatorët për shpërlarjen e mundshme të parave dhe financimit të terrorizmit

Indikatorët e shpërlarjes e mundshme të parave dhe aktiviteteve për financimin e terrorizmit, të paraqitur në vijim, si qëllim primar e kanë ngritjen e kujdesit në mesin e personelit të bankave dhe institucioneve financiare.

Nuk është qëllimi që këta indikatorë të jenë gjithëpërfshirës, por japin shembuj elementarë të mënyrave të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Sidoqoftë, identifikimi i secilit transakcion të paraqitur këtu kërkon analiza të mëtejme.

INDIKATORËT E PËRGJITHSHËM

Transakcionet struktura e të cilave paraqet ndonjë qëllim ilegal, qëllimin e tyre komercial e kanë të paqartë apo duket absurd nga pikëpamja komerciale.

Transakcionet ku arsyeja e klientit për zgjedhjen e institucionit apo degës financiare që do të kryejnë transakcionin është e paqartë.

Transakcionet të cilat nuk përputhen me njohurinë mbi ndërmjetësuesit financiar dhe përvojën e klientit si dhe qëllimin e paraqitur të marrëdhënies së biznesit.

Klientët të cilët institucionit financiar i japin informata të pavërteta apo dezorientuese, apo që refuzojnë pa ndonjë arsye bindëse të japin informatat apo dokumentet e caktuara, të cilat kërkohen dhe të cilat duhet të ipen rregullisht në aktivitetet e biznesit përkatës.

Transakcionet me vendet apo juridiksionet të cilat nuk bashkëpunojnë me Task-Forcën për Veprim Financiar (FATF), apo marrëdhëniet e biznesit me homologët që ndodhen në këto vende.

Kryerja e transaksioneve nën limitin që kërkon identifikimin e klientit apo raportimin e transakcionit.

Strukturës së marrëdhënies së biznesit të klientit me institucionin financiar i mungon arsyeshmëria logjike (numër i madh i llogarive në institucionin e njëjëtë, transfer i shpeshtë ndërmjet llogarive, likuiditet i tepruar, përdorim i tepruar i parave të gatshme aty ku lloji i biznesit nuk kërkon para të gatshme, etj.)

Transferet e shumave të mëdha, apo transferet e shpeshta në apo nga vendet të cilat prodhojnë drogë apo që janë të njohura për aktivitete terroriste.

Klienti tenton t'i shmanget përpjekjeve të ndërmjetësuesit financiar për vendosjen e kontaktit personal.

Klienti kërkon përfundimin e marrëdhënies së biznesit dhe fillimin e një marrëdhënie të re në emër të tij apo në emër të ndonjë anëtarit të familjes, duke mos lënë ndonjë dokument gjurmimi.

Klienti ka qenë i ndjekur për vepër penale, duke përfshirë korrupsionin apo keqpërdorimin e fondeve publike.

Transakcionet që në bilancin e klientit befasisht rezultojnë në zero.

Aplikacioni për formularin e biznesit nga klienti potencial, nga ndonjë vend i largët, ku një shërbim i ngjashëm mund të ofrohet në afërsi të shtëpisë së tij.

Aplikacioni për biznes jashtë sistemit normal të institucionit financiar.

Çfardo mungese e informatave apo vonesë në sigurimin e informatave që do të mundësonin verifikimin komplet.

Çfardo transaksioni i propozuar që përfshinë ndonjë palë të panjohur.

Provizione fillestare jashtëzakonisht të larta.

INDIKARORËT SPECIFIK PËR BANKA DHE INSTITUCIONE FINANCIARE

Transaksionet që involvojnë tërheqjen e mjeteve menjëherë pas depozitimit të tyre në bankë (kalimit nëpër llogari).

Transaksionet që rezultojnë në një aktivitet të theksuar por të paspjegueshëm të një llogarie që më parë ka qenë kryesisht e fjetur.

Këmbimi i shumave të mëdha të bankënotave me vlerë të vogël (EURO apo të huaja) në banknota me vlera të madha.

Këmbimi i shumave të mëdha të parave pa kreditimin e llogarisë së klientit apo që dallon nga rrjedha normale e biznesit të klientit.

Kthimi i çeqeve në shuma të mëdha të parave, duke përfshirë çeqet e udhëtimit, që nuk përkasin me rrjedhën normale të biznesit të klientit.

Blerja apo shitja e shumave të mëdha të metaleve të çmueshme, që nuk përket me rrjedhën normale të biznesit të klientit.

Blerja e çeqe bankare në shuma të mëdha, që nuk përket me rrjedhën normale të biznesit të klientit.

Udhëzimet për transfere të jashtme nga klientët e rastit, pa ndonjë arsye të mirëfilltë legjitime.

Përvetësimi i instrumenteve mbajtëse me anë të dërgesës fizike.

Depozitat apo tërheqjes e shpeshta të shumave të mëdha të parave të gatshme, të cilat nuk mund të spjegohen me motivin e biznesit të klientit.

Përdorimi i mjeteve kreditore, të cilat edhe pse normale në një treg ndërkombëtar, nuk përputhen me aktivitetin e njohur të klientit.

Llogaritë, nëpërmes të cilave sillen një numër i madh i llogarive, edhe pse zakonisht nuk shfrytëzohen ato llogari, apo shfrytëzohen deri në një kufi të caktuar.

Ofrimi i sigurisë (pengjet, garantuesit) nga palët e treat që janë të panjohur për institucionin financiar, të cilët nuk kanë ndonjë lidhshmëri me klientin dhe të cilët nuk kanë arsye të qarta dhe të besueshme për të ofruar garanci të tilla.

Pranimi i fondeve të transferuara nga institucionet tjera financiare ku emri apo numri i llogarisë të përfituesit apo dërguesit nuk janë paraqitur.

Transferet e shumave të mëdha të parave së bashku me udhëzimin që përfituesit t'i paguhen para të gatshme.

Një numër i madh i individëve të ndryshëm që depozitojnë para të gatshme në një llogari të vetme.

Kthimi i papritur e kredisë pa ndonjë spjegim të besueshëm.

Tërheqja e fondeve menjëherë pas depozitimit të tyre në llogari (kalimit nëpër llogari).

Kreditë në mirëbesim (kredi të dyfishta) për të cilat nuk ekziston ndonjë shpjegim i ligjshëm.

Kërkesa e klientit për dëftesë për tërheqjen së parave apo dërgesën e letrave me vlerë, të cilat në fakt nuk kanë ndodhur asnjëherë, pas të cilave menjëherë pason depozitimi i atyre mjeteve në bankën e njëjtë.

Kërkesa e klientit për ekzekutimin e urdhër- pagesës me detaje të pasakta të dërguesit.

Klienti kërkon që pagesa e caktuar të sillet nëpër llogaritë vetanake (nostro) të mbajtura nga ndërmjetësuesi financiar apo në llogari të ndryshme në vend të llogarisë së vetë.

Kërkesa e klientit të pranoj apo regjistroj në llogari kolateralin e kredisë që nuk është në përputhje me realitetin komercial, apo dhënia e huave në mirëbesim për të cilat kolaterali nacional regjistrohet në llogari.

Klienti ka disa llogari në degë të ndryshme të së njëjtës bankë, gjë që nuk përkon me natyrën e biznesit të klientit.

Klienti depoziton shuma të mëdha të parave të gatshme për kompaninë e cila normalisht nuk punon me para të gatshme.

Transaksione të shpeshta dhe të pazakonshme në mes të llogarisë personale të klientit dhe asaj të biznesit.

Themelimi i biznesit nga një agjent/ndërmjetësues në juridiksionet e pa rregulluara apo me një rregullim të dobët, apo ku dominojnë aktivitetet kriminale.

INDIKATORËT SPECIFIK PËR AGJENTËT E LETRAVE ME VLERË

Një marrëdhënie biznesi që ka qenë joaktive papritur bën investime të mëdha që nuk përputhen me praktikën e zakonshme të investimit apo me mundësitë financiare të klientit.

Klienti dëshiron të blej letra me vlerë, ku transaksioni nuk është në përputhje me praktikën normale të investimit apo me mundësitë financiare të klientit.

Klienti përdorë firmën e brokerimit apo letrave me vlerë si vend për mbajtjen e fondeve të cilat për një kohë të gjatë nuk përdoren për letrat me vlerë, prandaj një aktivitet i tillë nuk përputhet me praktikën normale të investimit apo me mundësinë financiare të klientit.

Klienti jep shuma të mëdha apo të pazakonshme të parave të gatshme për letrat me vlerë.

Transferet e fondeve dhe letrave me vlerë nëpër llogaritë të cilat nuk janë të ndërlidhura me klientin.